



Titulli i qëndrimit

Për të banuar më gjatë në Zvicër apo për të punuar, është nevojshme leja. Njeriu dallon leje të ndryshme qëndrimi dhe leje me vendqëndrim.

Llojet e lejës

Kush gjatë qëndrimit në Zvicër punon apo qëndron më shumë se tre muaj, i nevojitet për këtë një leje. Komuna e banimit është vendi i parë pothuajse për të gjitha pytjet për leje qëndrim në Zvicër. Ajo i dërgon kërkesat për leje qëndrim në shërbimin për migrim. Shërbimi për migrim merr vendimet. Ka dallime në mes lejeve të shkurtëra të qëndrimit (deri 1 vit), leje qëndrimi (varet nga nacionaliteti të kufizuara në një vit apo pesë vite) dhe leje qëndrimi (të pa kufizuara) dhe lejet për kalimin e kufinjëve.

- **Leja e shkurtër e qëndrimit (L):** (letërnjoftimi L, Ausweis L | livret L): Kjo leje është për personat, të cilët për një kohë të caktuar (më së shumti një vit) për një arsye të caktuar jetojnë në Zvicër. Në përgjithësi banoret dhe banorët nga shtetet EU-/EFTA, që mund ta dëshmojnë një marrëdhënie pune prej 3 muaj deri në një vit (kontratë pune), kanë të drejtën e kësaj leje.
- **Leja e qëndrimit B:** (letërnjoftimi B, Ausweis, Ausweis B, | livret B): Kjo leje është për personat, të cilët kanë qëndruar gjatë në Zvicër. Shumica e banoreve dhe banorëve prej shteteve të EU/EFTA, kanë një të drejtë për këtë, nëse mund ta dëshmojnë, që më shumë se një vit punojnë në Zvicër (Arbeitsvertrag|contrat de travail). Leja e qëndrimit u ndahet banoreve dhe banorëve të EU/EFTA për pesë vite. Për personat nga shtetet e tjera është leja e vlefshme për një vit. Pastaj duhet të bëhet kërkesa për vazhdim. Vazhdimi mundet të këta persona të ndërlihet me kushte, p.sh. shkuarja në një kurs të gjuhës gjermane. Të drejtën për vazhdim të leje qëndrimit nuk mund ta kenë të gjithë. Arsyet, që flasin kundër një vazhdimi mund të jenë, p.sh. shkelja e ligjit apo mvarësia financiare. Edhe refugjatët të pranuar e marrin vizën-B.
- **Leja me vendqëndrim (C):** Këtë leje e merr njeriu pas 5 apo 10 vite qëndrimi në Zvicër. Kjo leje me vendqëndrim nuk mund të ndërlihet me kushte.
- **Pranime të përkohshme (F):** Këtë leje e marrin kërkuarit e azilit, të cilët nuk pranohen si refugjatë, mirëpo merren përkohësisht. Leja duhet çdo vit të vazhdohet.



Letërnjoftimi për të huaj

Të huajat dhe të huajt, që banojnë në Zvicër, e marrin një letërnjoftim për të huaj. Lloji i letërnjoftimit është i varur prej kriterëve të ndryshme. Ka letërnjoftime në formatin e kartelës të kredisë dhe letërnjoftime nga letra (letërnjoftim jo biometrik për të huaj (Nicht biometrischer Ausländerausweis | Titre de séjour non biométrique). Disa persona e marrin një letërnjoftim biometrik për të huaj. Kjo kartë identiteti ka një çip me të dhëna, gjurmët e gishtërinjve, fotografinë e fytyrës dhe nënshkrimin dhe një fotografi. Personat në fjalë do të marrin një ftesë për takim nga shërbimi i migracionit. Më pas ata mund të regjistrojnë të dhënat e tyre biometrike nga Shërbimi i Pasaportave dhe Kartës së Identitetit të Kantonit të Bernës. Të gjitha letërnjoftimet mundën me u marr në komunën e banimit. Nëse vidhet letërnjoftimi apo humbet, duhet menjëherë të lajmërohet në polici.

Vazhdimi

Varësisht nga lloji i statusit të qëndrimit dhe përkatësisë shtetërore, duhet leja e qëndrimit në kohë të ndryshme të caktuara të vazhdohet. Nëse është një vazhdim i nevojshëm, e merr njeriu një formular me afat skadimi (Verfallsanzeige | avis de fin de validité). Ky formular duhet të plotësohet dhe s`bashku me një pasaportë të vlefshme më s`voni dy javë para kalimit të lejës të qëndrimit duhet të dorëzohet në komunën përkatëse. Komuna e dërgon kërkesën tutje në zyrën për shërbime të popullit (ABEV | OPOP). Kjo i vërteton, se a janë përmbushur kushtet për vazhdimin e lejës të qëndrimit. Nëse keni pyetje ju informojnë komuna e banimit apo shërbimi për popull (ABEV | OPOP).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/mire-me-dit/titulli-i-qendrimit